



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ZYRËS SË RREGULLATORIT TË ENERGJISË PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të ZRRE kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryesuesi i Bordit i Zyrës së Rregullatorit për Energji është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryesuesi i Bordit i Zyrës së Rregullatorit për Energji është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesuesi i Bordit i Zyrës së Rregullatorit për Energji është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që

cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKAsë, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë procesit të auditimit, kemi identifikuar disa fusha ku mund të përmirësohet performanca duke përfshirë kontrollin e brendshëm. Testet tona kanë treguar që nevojiten përmirësime në respektimin e rregullave financiare në procesimin e pagesave, pranimin dhe protokolimin e faturave dhemenaxhimin e pasurisë.

Raporti i auditimit ka rezultuar me tri (3) rekomandime. Prej tyre, dy (2) të reja dhe një i përsëritur. Ne do ti përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2023 ishte 228,332€, prej tyre ishin shpenzuar 224,972€.

Çështja A1 - Zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhër blerjës pas pranimit të faturës

Gjetja Rregulla financiare Nr.01/2013, në nenin 15, përcakton që procedurat e blerjes duhet të fillojnë me një kërkesë për blerje, pastaj zotimi i mjeteve, pas të cilës duhet të procedohet me urdhër blerje, pranimin e mallit ose shërbimit, shpenzimi dhe më në fund pagesën e faturës.

Gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur se në gjashtë (6) raste me vlerë të pagesave prej 4,952€, zotimi i mjeteve dhe urdhër blerjet ishin proceduar pasi kishte ardhur fatura.

Kjo ka ndodhur për shkak të moszbatimit të procedurave ligjore për shpenzimet e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave mund të shkaktojë ndikim të mos kryerjes se obligimeve të faturuara në kohë, duke çuar në rritjen e detyrimeve të papaguara, që në fund do të shkaktojnë probleme për buxhetin e vitit të ardhshëm.

Rekomandimi A1 Kryetari i Bordit të ZRRE-së duhet të sigurohet që, zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhër blerjeve bëhet para se të pranohen mallrat dhe faturat, në mënyrë që të respektohen procedurat dhe të evitohet rritja e detyrimeve të pa paguara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Mos protokollimi i faturave të pranuar

Gjetja Rregulla financiare Nr.01/2013, neni 24 Pranimi dhe pagesa e faturës, paragrafi 1.3 Fatura të protokollohet dhe të evidentohet në librin e faturave.

Kemi vërejtur se në dy (2) raste me vlerë të pagesave prej 3,300€, janë realizur pagesa bazuar në fatura të cilat nuk ishin Protokolluar nga

Organizata.

Kjo kishte ndodhur për shkak të pakujdesisë së zyrtarëve të organizatës gjatë procesit të protokollit.

Ndikimi

Mos protokollimi i faturave të pranuar rritë rrezikun që ato mos të regjistrohen në kohë, të mos raportohen detyrimet sipas faturave dhe të shkaktohen vonesa në pagesën e tyre.

Rekomandimi A2

Kryetari i Bordit të ZRRE-së duhet të siguroj zbatimin e të gjitha procedurave të kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit dhe të bëhet protokollimi i faturave sipas legjislacionit në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 117,407€, pasurive jokapitale është 62,345€ si dhe e stoqeve është 2,016€.

Çështja B1 - Mos përdorimi i sistemit e-pasuria

Gjetja Sipas nenit 6.3 të rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare – Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria.

ZRRE nuk përdor sistemin “e-pasuria” për regjistrimin e pasurisë jo-kapitale dhe stoqet, mirëpo këto evidenca mbahen në regjistra të brendshme në formatin excel.

ZRRE kishte ndërmarr veprime më qëllim të funksionalizimit të sistemit e-pasuria mirëpo gjatë periudhës raportuese nuk kishte arritur të regjistroj pasuritë në këtë sistem për shkak të mungesës së trajnimeve të duhura të zyrtarit përgjegjës për regjistrimin e tyre në e-pasuria.

Ndikimi Mos funksionalizimi i sistemit të e-pasurisë ndikon në mos përmbushjen e kërkesave ligjore për menaxhim të pasurisë. Po ashtu, regjistrimi i pasurive jo kapitale në Excel ku ekziston mundësia e ndryshimeve në çdo kohë pa lënë ndonjë gjurmë, rritë rrezikun që informatat e shpalosura në PFV mund të jenë të pasakta dhe jo të plota.

Rekomandimi B1 Kryetari i Bordit të ZRRE-së duhet të marrë veprime të nevojshme për ta vënë në funksion sistemin e-pasuria.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	799,856	696,843	680,982	708,181	644,732
Grante Qeveritare – Buxheti	799,856	696,843	680,982	708,181	644,732

Buxheti final është më i ulët në raport me buxhetin fillestar për 103,013€. Ky zvoglim është rezultat i vendimit nr. 69/2023 të dates 27/12/2023 nga MFPT.

Në vitin 2023, ZRRE ka shpenzuar afër 98% të buxhetit final ose 680,982€, me një rritje afër 4% krahasuar me shpenzimet e vitit 2022.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	799,856	696,843	680,982	708,181	644,732
Pagat dhe mëditjet	477,524	374,511	374,511	439,869	411,552
Mallrat dhe shërbimet	228,332	228,332	224,972	180,981	169,830
Komunalitë	22,000	22,000	10,687	17,076	14,114
Investimet Kapitale	72,000	72,000	70,812	70,255	49,235

Shpjegimet për ndryshimet në kategorinë e buxhetit janë dhënë si më poshtë:


Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 103,013€, Realizimi i buxhetit final ishte në masen prje 100%. Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte i njëjtë me atë fillestar, në vlerë 228,332€ dhe janë shpenzuar 224,972 apo mbi 98% e buxhetit final.

Buxheti final për komunalitë ishte i njëjtë me atë fillestar, në vlerë prej 22,000€, ndersa

shpenzimi ishte në vlerë prej 10,687€ apo rreth 49% e buxhetit.

Buxheti final për investime kapitale ishte i njëjtë me atë fillestar, në vlerë 72,000€, prej tyre ishin shpenzuar 70,812€ apo mbi 98% e buxhetit final.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga ZRRE per vitin 2023 ishin në vlerë: 7,638,992€.

Të hyrat në vlerë: 7,638,992€ janë realizuar nga dënimet - gjobat dhe nga të hyrat për licensa. Kjo rritje e të hyrave është ndikuar kryesisht nga gjobat/dënimet për shkeljet ligjore të konstatuara nga ZRRE ndaj operatorëve të energjisë elektrike gjatë vitit 2023 gjegjësisht arkëtimit të mjeteve nga shkelësit e ligjit.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	1,603,798	0	7,638,992	1,174,798	1,401,716
Të hyrat jo tatimore	1,603,798	0	7,638,992	1,174,798	1,401,716

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare (PFV-të) për vitin 2022 të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka identifikuar tre (3) rekomandime për të përmirësuar efikasitetin dhe proceset. ZRRE ka zhvilluar një plan veprimi për të adresuar këto rekomandime në mënyrë të detajuar.

Gjatë periudhës së auditimit për vitin 2023, dy (2) nga rekomandimet janë zbatuar me sukses, ndërsa një (1) ende nuk është adresuar. Për të dhënë një shpjegim më të detajuar të çdo rekomandimi dhe si janë trajtuar ato, ju lutemi referohuni tabelës 4 në vijim.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak





Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryesuesi i ZRRE-së duhet të sigurojë që personat përgjegjës për pasurit jo financiare të kenë trajnimet e duhura dhe t'u mundësohet qasje në SIMFK për regjistrim të pasurisë kapitale.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
2.	Pasuritë	Kryesuesi i ZRRE-së duhet të marrë veprime të nevojshme për ta instaluar sistemin e-pasuria.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryesuesi i ZRRE-së duhet të sigurojë se të gjitha mjetet në dispozicion të shfrytëzohen, përfshirë veprimet ligjore për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhër blerjës pas pranimit të faturës	<p>Përkitazi me këtë çështje, ZRRE dëshiron të potencoj se neni 15 i Rregullës Financiare Nr.01/2013 e të cilës i referohet Auditori, respektivisht paragrafit 4 thotë: "Sipas nenit 37.2 të LMFP, Zyrtari Kryesor Financiar i organizatës buxhetore është përgjegjës për regjistrimin e të gjitha faturave ose obligimeve tjera në SIMFK në përputhje me rregullat e MFK-së, brenda tri ditë pune pas pranimit të faturës ose ngritjes së obligimit përkatës, siç janë: regjistrimi i kërkesës për blerje/zotimi, urdhërblerja, pranimi i mallit, fatura/shpenzimi, certifikimi".</p> <p>ZRRE dëshiron të vë në pah se citimi i nenit 15 të Rregullës Financiare Nr.01/2013 nga Auditori në këtë gjetje nuk është citim plotësisht i saktë.</p> <p>Bazuar në këtë, ZRRE mendon se zbatimi i rekomandimit të Auditorit për këtë çështje praktikisht është i pamundur të realizohet.</p> <p>Sipas paragrafit 5 të nenit 15 të Rregullës Financiare Nr.01/2013, theksohet se: "Asnjë kontratë nuk do të nënshkruhet pa zotim të gjeneruar nga SIMFK për vitin actual fiscal. Zotimi I gjeneruar nga SIMFK është pjesë përbërëse e kontratës.</p> <p>Në asnjë rast AQP, si institucion që nënshkruan kontrata për ZRRE-në nuk ka kërkuar zotim të</p>	E gjetura qëndron – OB është pajtuar më gjetjen, dhe nuk ka ofruar dëshmi relevante për modifikimin e çështjes.

	<p>mjeteve për kontratat afatgjata për të cilat nuk dihet vlera e mjeteve që duhet të paguhen. Duhet potencuar gjithashtu se konstatimin e dhënë nga Auditori më së miri e demanton neni 17 i PVF-ve Raport për detyrimet (faturat) e papaguara, në të cilin vlera totale e obligimeve të pa paguara nga viti 2023 është 521.57€ dhe të gjitha këto obligime janë fatura të muajit dhjetor 2023, të cilat edhe ashtu pranohen pasi të përfundon viti fiskal, andaj mendojmë se ky konstatim i Auditorit është i pa bazuar.</p>	
--	--	--



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- **pajtohem pjesërisht** me gjetjet dhe rekomandimet në draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, për vitin 2023, dhe lidhur me këtë ZRRE ka dhënë komentet e saja në *Shtojcën I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit*.
- ✓ Me gjetjen Çështja A1 - *Zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhër blerjes pas pranimit të faturës*, dhënë nga auditori në draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, për vitin 2023, **nuk pajtohem**, ndërsa me dy gjetjet tjera: Çështja B1 - *Mos përdorimi i sistemit e-pasuria dhe Çështja A2 - Mos protokolimi i faturave të pranura*, **pajtohem**.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Ymer Fejzullahu
Kryesues i Bordit të ZRRE-së
Data: 25.06.2024

Nënshkrimi: 



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.